



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2018:060000

Datë: 29.11.2019

Numri i dokumentit: 00683402

P.nr. 259/2013

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN DEGA NË SUHAREKË, Gjyqtari Qemail Suka, me pjesëmarrjen e Sek. Juridike Vjollca Haziraj, në lëndën penale sipas P.Th. nga Prizreni, aktakuzës **PP/II.4391/12** të datës **03.05.2013**, ndaj të pandehurit E Xh nga fshati T komuna P, E Xhnga fshati T komuna P dhe M Xh nga fshati T komuna P për shkak të dyshimit të bazuar se kane kryer veprën penale vjedhja e rende nga neni 253 paragrafi 1 e lidhur me nenin 23 i Kodit Penal, në prezencë të prokurorit të PTH-së, nga Prizreni Atnor Skoro dhe të akuzuarit, në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me **dt.26.11.2019**, mori, publikisht shpalli dhe me **date 27.11.2019** përpilo këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari E Xhi lindur me dt.01.10.1988 nga i ati A, e ëma Xh e lindur M, me vendbanim në fshatin T komuna P, ku dhe tani jeton në P rruga “B C”, p.n,(afër ministrisë së Shëndetësisë) i pa pune, i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës.

I akuzuari Ei lindur me dt.18.11.1982 nga i ati A, e ëma Xh e lindur M, me vendbanim në fshatin T komuna P, ku dhe tani jeton në P rruga “Sh H “p.nr, i pa pune, i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës.

I akuzuari M Xh i lindur me dt.20.12.e ëma N e lindur ,me vendbanim në fshatin T komuna P, ku dhe tani jeton në P rruga ”, p.n, i pa pune, i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës.

JENË FAJTOR

Sepse me datë 03.07.2012 rreth orës 04:⁰⁰ minuta, në fshatin S komuna S, saktësisht në lokalitetin N.T.SH të “D” pronë e tani e dëmtuarit Q L, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo personin tjetër në bashkëkryerje ia marrin pasurinën e luajtshme të dëmtuarit, në atë mënyrë që të pandehurit në baze të marrëveshjes paraprake dhe në bashkëpunim, ditën kritike shkojnë tek lokali i lartecukur prone e të dëmtuarit dhe me përdorimin e forcës e thyejnë dritaren nga pjesa e pasme e lokalitetit, hyjnë brenda dhe marrin gjera ushqimore si pije alkoolike dhe prodhime të mishit dhe largohen nga vendi i ngjarjes, më q rast të dëmtuarit i shkaktojnë dem material në vlerë rreth 238 euro.

Me këto veprime ka kryer veprën penale vjedhja e rende nga neni 253 paragrafi 1 nen paragrafi 1 e lidhur me nenin 23 i Kodit Penal.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 41, 51, 52, 73, 74, 86 KP si dhe 359 par. 1 dhe 2 dhe neni 365 KPK-së, iu shqipton:

Dënim me kusht

Te akuzuarit **E Xh**,

Duke ia caktuar denimin prej 9 (nëntë) muajve burgim i cili denim nuk do te ekzekutohet nese ne afatin e verifikimit prej 2 viteve nuk kryen vepra tjera penale, pas plotfuqishmerise se ketij aktgjykimi.

Te akuzuarit **EXh**,

Duke ia caktuar denimin prej 9 (nëntë) muajve burgim i cili denim nuk do te ekzekutohet nese ne afatin e verifikimit prej 2 viteve nuk kryen vepra tjera penale, pas plotfuqishmerise se ketij aktgjykimi.

Te akuzuarit **MXh**,

Duke ia caktuar denimin prej 9 (nëntë) muajve burgim i cili denim nuk do te ekzekutohet nese ne afatin e verifikimit prej 2 viteve nuk kryen vepra tjera penale, pas plotfuqishmerise se ketij aktgjykimi.

Obligohen te akuzuarit qe ne emer te kompenzimit te viktimave te krimit te paguajne shumen prej 30 euro secili veq e veq si dhe paushallin gjyqesor ne shumen prej 50 eurove secili veq e veq.

I demtuari **Q L** nga fshati **S** komuna Suharekë udhëzohet qe kërkesën pasurorë juridike ta realizoje ne kontest te rregullt civil.

A r s y e t i m

PTH-e me aktakuze, **PP/II.4391/12** të datës **03.05.2013**, ndaj të pandehurit E Xh nga fshati T komuna P,E Xh nga fshati T komuna P,dhe M Xh nga fshati T komuna P për shkak të dyshimit të bazuar se kane kryer veprën penale vjedhja e rende nga neni 253 paragrafi 1 e lidhur me nenin 23 i Kodit Penal,te cilin gjatë seancës se shqyrtimit fillestar ka përfaqësuar PSH nga Prizreni Atnor Skoro, duke kërkuar qe te akuzuarit te shpallen fajtor dhe te dënohen sipas ligjit.

Gjykata ne shqyrtimin e sotëm dhe me vet pranimin nga ana e te akuzuarve ka vërtetuar këtë gjendje faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga vet pranimi i te akuzuarve te cilet ne shqyrtimin fillestar e kane pranuar fajësinë.

Gjykata sipas detyrës zyrtare konform nenit 257 te KPP-së, ne shkresat e lendes nuk ka gjetur ndonjë prove te pa pranueshme dhe po ashtu gjykata ka vërtetuar se te akuzuarit, e kane kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi te fajësisë, pranimi i fajit nga ana e te akuzuarve, është bere vullnetarisht ne shqyrtimin fillestar, pranimi është mbështetur ne faktet e çështjes qe përmban aktakuza, te cilat gjinden ne shkresat e lendes si dhe provat materiale te paraqitura ndaj te akuzuarve nga ana e PTH-së ne Prizren.

Gjykata po ashtu ne tërësi ka ardhur ne përfundim se pranimi i fajësisë ne shqyrtimin fillestare nga ana e te akuzuarve, është bërë ne pajtim me dispozitat e nenit 248 te KPP-së, nga se nuk ekziston ndonjë nga aresyet dhe kushtet për hudhjen e aktakuzës, apo pushimin e procedurës penale.

Nga këto fakte te cilat i përmban aktakuza, Gjykata ka ardhur ne përfundim se me veprimet e te akuzuarve formohen te gjitha elementet e veprës penale vjedhja e rende nga neni 253 par.1 nenpar.1 lidhur me nenin 23 te KPK-së, andaj Gjykata ka vendosur se te akuzuarit jane fajtor dhe i u shqiptoi dënimin si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

Gjykata gjate marrjes se vendimit mbi dënimin ka vlerësuar te gjitha rrethanat ne kuptim te nenit 73 te KP-ës, te cilat ndikojnë ne lartësinë e dënimit.

Gjykata si rrethane lehtësuese mori për baze se te akuzuarit kanë pasur qëndrim korrekt ndaj Gjykatës, kane pranuar fajësinë ne mënyrë vullnetare, duke u penduar për veprën e kryer penale dhe zotuar se ne te ardhmen vepra te tilla apo te ngjashme nuk do te perseriten, mosha relativisht e re, kurse si rrethan renduese sepse edhe me pare kane rene ndesh me ligjin, Gjate shqiptimit te denimit Gjykata pati parasysh edhe qellimin e denimit qe te akuzuarve mos te i shkaktohen vuajtje por te njejtit te risocializohen.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike e mori ne kuptim te nenit 463 te KPP-së. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u mori ne kuptim te nenit 452 par, 1 te KPP-së.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA SUHAREKE

Gj y q t a r i
Qemail Suka

KESHILLE JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtine, përmes kësaj Gjykate.